



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 22/2018(JR)

Tiranë, më 21.03.2019

Nr. 22/8 regj.

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën **e enjte**, në datën **18.04.2019**, ora **11:00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentash çështja me numër regjistri 22/2018(JR), datë 19.10.2018, për ankimin që subjekti i rivlerësimit Admir Thanza ka bërë kundër vendimit nr. 40 datë 17.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Admir Thanza.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykses	Rezarta Schuetz
Relator i Çështjes	Ardian Hajdari
Gjyqtar	Ina Rama
Gjyqtar	Luan Daci
Gjyqtar	Natasha Mulaj

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të pakën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**KRYESUES I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR**

Rezarta Schuetz
REZARTA SCHUETZ

